

**AKT-THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE "NAMAZGJA EXCHANGE" SH.P.K.**

Ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit",ligjit nr 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " te ndryshuar, themelohet Shoqeria "NAMAZGJA EXCHANGE" SH.P.K, me seli ne Elbasan, lagja "Clirimi", pasuria me nr: 8/223-N.1 , Zona kadastrale nr 8522, nga ortaku i vetem i kesaj Shoqerie Z. Enerik Kadaifciu , i dtl 01/01/1956, lindur e banues ne Elbasan, i pajisur me numer personal : F60101120Q, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar i cili:

**VENDOS**

Te krijoje nje Shoqeri Tregtare te emertuar **"NAMAZGJA EXCHANGE" SH.P.K** me kushtet e meposhtme:

**NENI 1**

Themeluesi ne cilesine e ortakut te vetem krijon shoqerine tregtare **"NAMAZGJA EXCHANGE" SH.P.K** me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjit 129/2014, me mjetet e veta financiare duke paguar kontributin ne para.

**NENI 2**

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statutin e bashkelidhur.

**NENI 3**

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin **"NAMAZGJA EXCHANGE" SH.P.K** emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj.  
Ajo ka vullen e saj ne te cilen eshte shkruar **"NAMAZGJA EXCHANGE", SH.P.K, Elbasan, Albania.**

**NENI 4**

Shoqeria e ka seline e saj ne **Elbasan, Lagja "Clirimi", Pasuria me nr: 8/223-N.1, Zona kadastrale nr: 8522.**

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

**NENI 5**

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortaku i vetem vendos prishjen e saj.

**NENI 6**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me objekt :  
**"KEMBIM VALUTOR"**

**NENI 7**

Me vendimin e themeluesit te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

**NENI 8**

*Kokpa*

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte 2.500.000 (DYMILIONEPESQINDMIJE) leke shqiptare.  
Ortaku i vetem **Z. Enderik Kadaifciu** zoteron 1 kuote me vlere 2.500.000 (DYMILIONEPESQINDMIJE) leke ose 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

#### **NENI 9**

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte pergjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

#### **NENI 10**

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur.

Shoqeria do te drejtohet nga organet drejtuese qe perbehen nga ortaku i vetem dhe administratori. Themeluesi me vendim te veçante do te emeruje dhe nje ekspert kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", si dhe do te krijojë fondin rezerve.

Fitimi neto qe do te rezultojë ne fund te cdo viti financiar pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjeve te mbajtura nga vitet e meparshme do ti kalojë ortakut te vetem.

#### **NENI 11**

Percaktimi i struktures organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emerimet e shkarkimet ne organet e saj behen me vendim te ortakut te vetem te saj. Administratore e vetme e Shoqerise emerohet Zj. Rezarta Kadaifciu, e dtl 09/06/1990, lindur e banuese ne Elbasan, shtetase shqiptare, e pajisur me numer personal J05609081I, me kohezgjatje te mandatit per 5 vjet.

Administratorja e Shoqerise Rezarta Kadaifciu zoteron nje diplome Bachelor ne Informatike me nr: 2173 date 10/12/2012, dhe diplome Master Profesional ne Informatike Biznesi me nr: 978 date 12/12/2014.

Maredheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

#### **NENI 12**

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

**THEMELUESI I SHOQERISE TREGTARE  
"NAMAZGJA EXCHANGE" SH.P.K.  
Enderik Kadaifciu**

*Enderik Kadaifciu*

**Elbasan me 25 janar 2021**